



N.26  
Mars  
2026

REDAKSIA  
"ZKM ALBANIA"  
Qendra Spitalore  
Universitare  
"Zoja e Këshillit të Mirë"  
Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë

Facebook: unikzkm  
Instagram: unikzkm  
Website: www.unizkm.al  
Email: pr@fzkm.org

LAJME NGA FONDACIONI ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

# ÇMIMI PËR PAQEN SHQIPËRIA BESON

Në Universitetin Katolik ZKM, autoritete fetare dhe akademike ndërkombëtare u mbledhën për të festuar angazhimin e **Nihad Suljić** dhe projektit edukativ **"The Joint History Books Project"**



Paqja i bëri bashkë të gjithë në Universitetin Katolik Zoja e Këshillit të Mirë ndërsa për herë të parë me inisiativën dhe mbështetjen e jashtëzakonshme të Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë u dha Çmimi i Paqes në Shqipëri.

Sic tha edhe Presidenti i Fondacionit ZKM fr. Ruggero Valentini **është domethënëse sot në kohët e trazuara që jetojmë të flasim për paqen** dhe një çmim për këtë moment.

Duke u uruar mirëseardhjen shumë autoriteteve të larta fetare dhe akademike Presidenti i ZKM i dha udhë një ceremonie të veçantë që kulmoi me dhënien e Çmimit të Paqes për herë të parë për Nihad Suljić me motivacionin për angazhimin e





Në takimin ndërkombëtar që u moderua nga Drejtori i CESPIC Prof. Raul Caruso morën pjesë S.E.M Miroslaw Adamczyk, Nunci Apostolik në Shqipëri, Arqipeshkvi i Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë Mons. Arjan Dodaj, Hirësia e tij, Mitropoliti i Beratit, Vlorës dhe Kaninës, z. Asti, Dr. Luisa Chiodi Drejtoreshë e Observatorit të Ballkanit (Osservatorio Balcani Caucaso Transeuropa / CCT ), Prof. Alessandro Saggio Universiteti



tij të vazhdueshëm humanitar dhe kontributin e tij në komunitet për paqen sociale...”

si edhe për “The joint History Books project” me motivacionin për punën e tyre afatgjatë edukative që promovon mirëkuptimin dhe pajtimin reciprok.



Sapienza i Romës, Roberto Lupi President i Institutit të Skudeve të Shën Martinit të Firences etj. Takimi ndërkombëtar vlerësoi rolin e madh që luajnë përpjekjet për paqe në botën e sotme dhe frymëzimin që vjen nga shembuj si Nihad apo projekti i librave për të edukuar brezin e ri me tolerancë, bashkëjetesë dhe domosdoshmërinë e qasjes paqësore ndaj vështirësive e sfidave.

# MBUROJA E SHËN MARTINIT

Vitin e kaluar "mburoja" ishte në Principatën e Monakos ndërsa vitin e ardhshëm do të jetë në OKB në Nju Jork. Lajmi është se në vitin 2026 ky model do të qëndrojë në Tiranë pranë Universitetit “Zoja e Këshillit të Mirë”.

Më 11 mars erdhi për ta dorëzuar personalisht tek ne Roberto Lupi president i Institutit “Mburojat e Shën Martinit” të Firences (<https://scudisanmartino.com>), i fotografuar së bashku me prof. Bruna Marzucchini si dhe me presidentin dhe zëvendës presidentin e Fondacionit tonë. Instituti fiorentin vlerëson çdo vit individë të shumtë nga e gjithë bota që kanë kryer akte me vlerë të lartë njerëzore në situata emergjence dhe rreziku. Me këtë vlerësim marrëdhënia e Universitetit ZKM me qytetin kryesor të Toskanës dyfishohet pasi shton bashkëpunimin e frytshëm me Universitetin e Firences prej tashmë dhjetë vitesh përmes diplomës së dyfishtë në arkitekturë.



Dorëzimi i (të) Mburojës së Shën Martinit në Universitetin Katolik NSBC në Tiranë nga **Dr. Roberto Lupi**, President i Institutit “Scudi di San Martino” të Firences.

## Firence dhe ne



Mburoja e Shën Martinit

# GJESTI I PAQES

Mes zhurmave të luftimeve dhe fjalimeve të urrejtjes

Fjala përshëndetëse në hapje të ceremonisë së Çmimit CESPIC

**Q**ë të mos zgjatëm shumë dua të ndaj me ju vetëm disa mendime si shkëndija frymëzimi që ngjarjet e sotme zgjuan mes nesh.

Në realitet sot kanë folur më shumë veprimet sesa fjalët: ndarja e Çmimit të parë për paqe CESPIC për Nihad Suljić dhe për Projektin Joint History Books

dorëzimi në Universitetin tonë i "Modelit" të Mburojave të Shën Martin

përfshirja e dy figurave të reja të humanizmit në Kopshtin e Të Drejtëve si Falcone dhe Borsellino.

## NDËRTOJMË PAQEN ÇDO DITË

Mesazhi i Rektorit

Të nderuara Zonja dhe Zotërinj,

autoritete të nderuara, kolege dhe kolegë, të dashura studente dhe studentë. E hapim këtë ditë të CESPIC Peace Award në një moment historik, veçanërisht kritik për paqen. Në vitet e fundit jo vetëm që janë shtuar luftërat dhe konfliktet, por është përhapur pothuajse në mënyrë të heshtur ideja se përdorimi i forcës është një metodë normale e marrëdhënieve midis shteteve, një instrument i zakonshëm i politikës ndërkombëtare. Rënia e së drejtës ndërkombëtare, e cila anashkalohet vazhdimisht ose shkelet hapur, si edhe përhapja e një gjuhe agresive, polarizuese, madje edhe çnjerëzore, janë ndoshta shenjat më të dukshme të perëndimit të një horizonti paqeje globale që për disa dekada kishim besuar se ishte i pakthyeshëm. Riarmatosja, si në fjalë ashtu edhe në veprime, po përparon me ritme që rikujtojnë periudhat më të errëta të shekullit XX. Rriten buxhetet ushtarake, normalizohet retorika e përplasjes dhe flitet me lehtësi për



**Fr. Ruggero Valentini**  
Presidenti i Fondacionit  
"Zoja e Këshillit të Mirë"

Në lutjen e mëngjesit lexuam një fragment nga Libri i Isaisë (33, 15-16) që në pak rrjeshta përcakton kush janë paqebërësit dhe të drejtët:

*"Ai që ecën me drejtësi dhe flet drejt, ai që i përçmon fitimet e shtrembra, ai që lëviz duart për të mos pranuar dhurata që i mbyll veshët për të mos dëgjuar të flitet për gjak dhe sytë për të mos parë të keqen, ai do të banojë në vende të larta, tek shkëmbinjtë e fortifikuar do të jenë streha e tij, buka e tij do t'i jepet, uji i tij do të sigurohet".*

Paqja nuk është një ideologji dhe as një utopi: paqja gjendet në veprat e përbashkëta shpesh të përulura dhe të heshtura për të mirën e secilit.

Artizanët e paqes janë burra dhe gra konkretë: dëshira është që në këtë universitet, në këtë spital të rriten ata që ndërtojnë paqe përmes akteve të një jete të mirë.

**Prof. Leonardo Palombi**  
Rektor i Universitetit Katolik  
"Zoja e Këshillit të Mirë"



përshkallëzim dhe për "pashmangshmërinë" e konflikteve. Në këtë kontekst, tingëllon me një qartësi të veçantë vizioni i Papa Françeskut kur ai e përshkruan kohën tonë si një "Luftë Botërore të copëzuar": një luftë e përhapur dhe e fragmentuar, që përshkon kontinente të ndryshme, por që ka rrënjë të përbashkëta te frika, pabarazia dhe refuzimi për t'i njohur tjetrit të njëjtin dinjitet. Pikërisht në këtë skenar, CESPIC Peace Award merr një domethënie të veçantë. Pasi, ndërsa horizonti global duket se po largohet nga paqja, ne sot zgjedhim të kthejmë vështrimin drejt atyre që në jetën e përditshme përpiqen ta mbajnë atë gjallë: përmes gjeesteve njerëzore përgjatë kufijve, librave që çaktivizojnë urrejtjen, shtigjeve të pajtimit që i rikthejnë kuptimin ligjit dhe fjalës. Sot ne nuk dorëzojmë vetëm një çmim, por nderojmë histori dhe përvoja që na tregojnë çfarë do të thotë të ndërtohet paqen në mënyrë konkrete, në kohët tona dhe në vendet tona. Evropa Juglindore e njeh mirë çmimin

e luftës dhe të ndarjeve. Kujtimet e konflikteve të fundit, plagët ende të hapura, si dhe lëvizjet e njerëzve që kalojnë kufijtë tanë, na kujtojnë çdo ditë sa e brishtë është paqja dhe sa shumë kërkon kujdes, përgjegjësi dhe këmbëngulje. CESPIC Peace Award lind pikërisht për t'u dhënë vizibilitet atyre që shpesh larg vëmendjes së mediave punojnë për ta shndërruar këtë vetëdije në veprimtari humaniteti, dialogu dhe pajtimi. **Fituesit e çmimeve të këtij viti përfaqësojnë dy dimensione plotësuese të paqes.**

Nga njëra anë, paqja e përditshme e angazhimit humanitar, e përbërë nga takimet sy më sy, nga duar të shtrira përgjatë rrugës ballkanike, nga dinjteti i rikthyer atyre që janë në arrati nga luftërat dhe dhuna. Nga ana tjetër, paqja plot durim e edukimit dhe e kujtesës, e cila kalon përmes librave



shkollorë, klasave dhe përbashkës kritikë mes rrëfimeve të ndryshme të historisë sonë. Me çmimin për Nihad Suljiç duam të nderojmë guximin e përvullur të një aktivisti të ri që duke nisur nga Tuzla, zgjedhi të qëndrojë pranë refugjatëve dhe njerëzve në lëvizje. Angazhimi i tij përkthehet në ndihmë materiale, dëgjim dhe orientim, por edhe në kujdes për ata që nuk ia kanë dalë, në mënyrë që askush të mos mbetet pa emër dhe pa kujtesë. Në këtë mënyrë, vendet kufitare të shënuara nga frika shndërrohen në hapësira humaniteti dhe përgjegjësi të përbashkët. Me çmimin për Zvezdana Kovač, Christina Koulouri dhe për Joint History Project, ne nderojmë ata që kanë ditur ta shndërrojnë historinë nga një terren përplasjeje në një hapësirë dialogu.

Përmes teksteve shkollorë me shumë perspektiva dhe bashkëpunimit midis historianëve dhe mësuesve nga shumë vende të rajonit, projekti i ndihmon brezat e rinj të përbashkët me rrëfime të ndryshme, të njohin vuajtjet e ndërsjella dhe të ndërtojnë një kujtesë më të drejtë dhe më të përbashkët për të kaluarën e Ballkanit. Është një punë e ngadaltë, por thelbësore, sepse pa një kujtesë pajtimi nuk mund të ketë një paqe të qëndrueshme. **Nihad Suljiç, Zvezdana Kovač, Christina Koulouri dhe Joint History Project** na kujtojnë se paqja nuk është një fjalë abstrakte, por një praktikë e përditshme. Ajo ndërtohet përmes gjesteve ndaj atyre që janë më të cenueshëm, në mënyrë se si e tregojmë historinë tonë dhe në zgjedhjet arsimore që bëjmë për brezat e ardhshëm. Përmes CESPIC Peace Award duam të themi se ky angazhim ka rëndësi,



ka vlerë për shoqëritë tona dhe se mund të jetë burim frymëzimi për të gjithë ne. Atyre u shkon mirënjohja jonë më e thellë për qëndrueshmërinë, këmbënguljen dhe shpresën që mishërojnë.

Dhe për të gjithë ne mbetet ftesa që të reflektojmë mbi shembullin e tyre, duke pyetur veten se çfarë kontributi mund të ofrojmë, në rolet dhe në kontekstet tona, në mënyrë që kufijtë të shndërrohen në ura, që kujtesa të kthehet në përgjegjësi dhe që rajoni ynë të bëhet gjithnjë e më shumë një hapësirë bashkëjetese, dialogu dhe paqeje.



FAQE 16 | *Një letër falënderimi nga Nihad Suljiç drejtuar anëtarëve të jurisë dhe organizatorëve*

# NJË KOPSHT PËR TË ARDHMEN

Falkone dhe Borselino, dy gjyqtarë simbol i drejtësisë



Xhovanni Falkone lindi në Palermo në vitin 1939. Paolo Borselino lindi në të njëjtën lagje tetë muaj më vonë, në vitin 1940. Që kur ishin fëmijë luanin futboll së bashku në oborrin e kishës, ndërsa kur u rritën zgjedhën të njëjtin profesion, atë të gjyqtarit, në shërbim të Republikës, jo të një partie. Edhe pse ishin me bindje politike të kundërta Paolo i dhathtë ndërsa Xhovanni i majtë, ata ndanë të njëjtin pasion për punën. Rrugët e tyre u kryqëzuan pas fëmijërisë në fund të viteve '80 kur u thirrën në grupin e parë antimafia duke arritur rezultate të jashtëzakonshme.

Ngritën me profesionalizëm një proces gjyqësor me 474 të pandehur madje në burg përfunduan edhe politikanë të fuqishëm siçilianë të kohës. Por grupi nuk i



mbijetoi pengesave kritike. Falkone u sabotua, u braktis nga kolegët derisa u eliminua fizikisht më 23 maj 1992 në një atentat brutal në autostradë. Borselino e ndjente se vdekjen e kishte afër. I rrëfeu gruas së tij se ekzistonte një marrëveshje midis mafies dhe ngrëzve jo besnikë ndaj shtetit.

Edhe ai u eliminua më 19 korrik të po atij viti. Sot kujtohet edhe shprehja

e Falcones: "Vdesim sepse jemi të vetëm ose sepse kemi hyrë në një lojë shumë të madhe... sepse na mungon mbështetja.

"Ata lanë pas një Itali me më shumë të vërteta mbi të keqen e saj më të madhe, ndërsa sot nderojmë jetët e tyre që bëhen thirrje për të gjithë ata që e duan vendin e tyre të lirë nga mafia. Të Drejtët nderohen çdo 6 mars për kontributin që kanë dhënë

në komunitete të ndryshme sipas një vendimi të Parlamentit Evropian. **Kopshti i të Drejtëve në Kampusin e Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" u inauguroa në vitin 2024** për të kremtuar njëzet vjetorin e themelimit të Universitetit ZKM.

Ky kopsht është i vetmi në Shqipëri i ndërtuar me këtë motivacion.

# ZBULOHEM NJË TJETËR GUR NË KAMPUSIN ZKM

Për ata që dhanë jetën për drejtësinë

Inauguroam për të tretin vit rradhazi një tjetër gur në nderim të Të Drejtëve për vitin 2026. Ceremonia e zbulimit të gurit të mermerit ku janë gdhendur emrat për këtë vit u krye pas një votimi demokratik që u zhvillua në Kampusin ZKM gjatë janarit të këtij viti.

Të Drejtët 2026 u zgjodhën magjistratët Xhovani Falkone dhe Paolo Borselino, të cilët rezultuan si më të mbështeturit nga votimi demokratik në Kampusin tonë universitar.

Këtë vit në ceremoninë e zbulimit të gurit ku janë gdhendur emrat e magjistratëve ishin të pranishëm S.E.M Miroslaw Adamczyk, Nunci Apostolik në Shqipëri, Arqipeshkvi i Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë Mons. Arjan Dodaj, Hirësia e tij, Mitropoliti i Beratit, Vlorës dhe Kaninës, Z. Asti, Zv. Ambasadori Italian në Tiranë dhe të ftuar të tjerë.

Presidenti i Fondacionit ZKM por edhe Nunci Apostolik në mesazhet e tyre vlerësuan trashëgiminë e sakrificës sublime dhe drejtësisë që kanë lënë për brezat e rinj magjistratët e ndjerë që luftuan me përkushtim sublim realitetin e egër të mafies, realitetin e egër të Cosa Nostra-s që shtrihej me krimet dhe ndikimin e tij deri tek lidhjet me politikën, ekonominë apo grupimet e fshehta subversive.



Për shkak të kësaj lufte pa kompromis ata u vranë, ndaj sot në Kopshtin e vetëm në Shqipëri dhe Ballkan që u dedikohet Të Drejtëve ne vendosëm të gdhendim emrat e Falkones dhe Borselinos si dëshmorë të luftës për drejtësi dhe për një botë më të mirë.

Guri ku janë gdhendur emrat e tyre u mbulua me flamurin e paqes dhe momentin e zbulimit në publik e bënë së bashku dy autoritetet e larta të klerit në Shqipëri si Imzot Arjan Dodaj dhe Hirësia e tij Mitropoliti i Beratit Asti. Inaugurimi i emrave të Të Drejtëve në Kampusin ZKM është një ditë feste dhe reflektimi për të gjithë ne.



*Ipeshkvijtë Asti, nga Kisha Ortodokse dhe Arjan, nga Kisha Katolike, ngrenë flamurin e paqes për të "zbuluar" të Drejtët e rinj 2026*

# REVOLUCION PËR SHËNDETIN

Spitali Katolik sjell radiologjinë  
ndërhyrëse

Spitali Katolik është një pol referues për mbrojtjen e shëndetit në Shqipëri tashmë e konfirmuar edhe nga marrëveshjet ndërkombëtare, por edhe nga certifikimi i fundit i autoriteteve shtetërore shëndetësore.

Çdo vit Spitali Katolik i Tiranës **investon në teknologji** dhe së fundmi ka sjellë për herë të parë në Shqipëri shërbimin e **Radiologjisë Intervencionuese**. Ky investim shënon një moment të rëndësishëm në zhvillimin e mjekësisë moderne në vend. Kjo disiplinë që përfaqëson një arritje ndër më të avancuarat e radiologjisë, kombinon teknologjinë e imazherisë (si angiografia, ekografia, CT etj) me procedura minimale invazive për trajtimin e një game të gjerë patologjish.

Ky shërbim mjekësor që kryhet vetëm në Spitalin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” krijon mundësinë e trajtimeve të specializuara pa ndërhyrje kirurgjikale tradicionale duke reduktuar ndjeshëm rrezikun, dhimbjen dhe kohën e rikuperimit për pacientët. Radiologjia Intervencionuese përdoret në trajtimin e sëmundjeve vaskulare (si ngushtimet apo bllokimet e arterieve), në kontrollin e hemorragjive, në trajtimin e tumoreve përmes procedurave si embolizimi apo ablacioni (microëave ablatio, cryoablation, radiofrequenze ablation), si dhe në vendosjen e drenazheve dhe kateterëve terapeutikë.



*Ekipi i mjekëve i  
Spitalit 'Zoja e Këshillit të  
Mirë' pranë pajisjes  
moderne  
të radiologjisë*

Ky shërbim shënon në historinë e shëndetësisë në Shqipëri një hap të madh drejt modernizimit të sistemit shqiptar duke ofruar standarde të krahasueshme me ato të qendrave më modern evropiane.

Pajisjet bashkëkohore dhe stafi i specializuar mundësojnë trajtime të sigurt, efektive dhe të personalizuar për çdo pacient duke përmbushur më së miri misionin e institucionit tonë në edukimin dhe shërbimin ndaj shëndetit të popullatës.

Vendosja e Radiologjisë Intervencionuese në Spitalin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” jo vetëm që rrit cilësinë e shërbimeve mjekësore në vend, por gjithashtu ul ndjeshëm nevojën e pacientëve që të kërkojnë trajtim jashtë Shqipërisë duke sjellë teknologjinë dhe ekspertizën ndërkombëtare pranë komunitetit shqiptar. Spitali Katolik kthehet kështu në një arterie të rëndësishme edhe rajonale për avancimin e shërbimit mjekësor.

# HEMODINAMIKA NIS PUNËN

Sukses që në trajtimin  
e parë mjekësor

**K**abineti i ri i Hemodinamikës në Spitalin Katolik nisi nga puna dhe falë teknologjisë dhe ekipit u shënuar suksesi i parë në trajtimin e një rasti kompleks. Angiografi, një nga investimet e fundit teknologjike në Spitalin Katolik vijon t'u vijë në ndihmë pacientëve që kanë nevojë dhe duke zgjeruar aftësitë diagnostikuese për ekipet e mjekëve tanë.

Përvoja e mjekëve dhe pajisja bashkëkohore mundësuan trajtimin e një patologjie të rëndë koronare duke ofruar një zgjidhje minimale invazive për një rast që përndryshe do të ishte i vështirë për t'u trajtuar. Falë kësaj procedure të përparuar mjekët tanë arritën të trajtojnë me sukses një patologji komplekse koronare tek një pacient, i cili në të kaluarën i ishte nënshtruar një operacioni by-pass të aortës dhe arterieve koronare. Bllokimi prekte një pikë delikate të trungut komun, enës më të rëndësishme për mirë- funksionimin e zemrës. Ndërhyrja zgjati rreth 30 minuta dhe



u realizua duke përdorur teknikat dhe standardet e përcaktuara sipas protokolleve specifike. Kjo mundësoi hapjen e arterieve në mënyrë të saktë dhe të sigurtë. Rezultati ishte i menjëhershëm: qarkullimi i gjakut në enët koronare u rikthye normalisht dhe pa asnjë lloj komplikacioni.

Suksesi i vërtetë u vlerësua dhe u certifikua nga mjekët në orët në vazhdim kur pacienti u përmirësua shpejt dhe u kthye në shtëpi në gjendje të mirë shëndetësore vetëm 24 orë pas ndërhyrjes. Ky rast dëshmon edhe një herë se si teknikat minimale invazive të mbështetura nga teknologjia bashkëkohore si angiografi i ri ofrojnë sot zgjidhje efikase edhe për sëmundjet më të ndërlikuara të zemrës. Përfitimet për pacientët janë të shumta duke nisur me siguri të lartë ndërhyrjeje, qëndrim shumë të shkurtër në spital dhe kthim të shpejtë në jetën e përditshme duke ndihmuar kështu në mbrojtjen e shëndetit afatgjatë.

## INFERMIERËT MES BARNAVE DHE IA-SË

Drejt  
konferencës  
"Montianum"



*Ky është  
produkti i parë  
nga laboratorët e  
rinj farmaceutikë  
në Fakultetin  
e Farmacisë të  
Universitetit ZKM  
në Tiranë.*

Profesioni i infermierisë ka marrë një rol gjithnjë e në rritje në fushën shëndetësore: nga kujdesi në shtëpi deri te organizimi i ndihmës në një repart spitalor. Edhe roli profesional në administrimin e barnave ka pësuar një ndryshim të thellë deri sot kur në lojë hyn marrëdhënia me Inteligjencën Artificiale (IA). Këto

tema do të shqyrtohen me kujdes gjatë konferencës së ardhshme të organizuar nga Qendra "Montianum", më datë 1 qershor 2026, në Aula Magna të Universitetit Katolik të Tiranës. Qendra Ndërkombëtare për Kërkime Infermieristike mban emrin e infermierit fetar **Luigji Monti** themelues i Komunitetit që

ka promovuar Fondacionin "Zoja e Këshillit të Mirë". Vetë Monti shërbeu si ndihmës-farmacist duke i dhënë Kongregatës së tij një prirje të theksuar drejt prodhimit të barnave, e cila sot përfaqësohet nga kompania "IDI Farmaceutici" [www.idifarmaceutici.com](http://www.idifarmaceutici.com).

# STUDENTËT E SEMESTRIT FILTËR MBËRRIJNË NË TIRANË

Përshëndetja e Rektorit **Prof. Leonardo Palombi**, drejtuar studentëve të vitit të parë të mjekësisë në UKZKM (Kursi në italisht)



## Të dashur studentë

Me një emocion të veçantë ju mirëpres sot këtu! Një udhëtim i ri dhe i rëndësishëm fillon për ju, një udhëtim që do t'ju shoqërojë për shumë vite dhe që jam i sigurt do të lërë një gjurmë të thellë në jetën tuaj. Sot nuk po filloni thjesht studimet për Mjekësi, por po zgjidhni ti kushtoni energjitë, inteligjencën dhe zemrën tuaj në shërbim të shëndetit, jetës dhe dinjitetit të njerëzve. Është një zgjedhje e shkëlqyer që meriton respekt, admirim dhe mbështetje. E di mirë që për shumë prej jush arritja këtu nuk ka qenë e lehtë. Keni kaluar muaj pasigurie, pritjeje dhe pyetjesh për të ardhmen tuaj. I ashtuquajtur "semestri filtër",

vështirësitë organizative, ndryshimet e papritura... Por sot jeni këtu. Keni zgjedhur të vazhdoni përpara dhe kjo është tashmë një shenjë e karakterit që i duhet atij që dëshiron të bëhet mjek. Sepse Mjekësia nuk është vetëm dije, nuk është vetëm studim: para së gjithash është qëndrueshmëri, është të dish të qëndrosh në këmbë edhe në momentet e vështira.

Dhe sot, këtu në Shqipëri, ju filloni vërtet rrugëtimin tuaj. Në një vend që ju pret me miqësi, në një tokë që flet një gjuhë tjetër, por që ndan shumë me Italinë. Nuk jeni në një vend "të largët", por në një pjesë të gjallë të projektit të madh evropian të bashkëpunimit dhe të rritjes së përbashkët. Shqipëria dhe Italia janë

të lidhura nga marrëdhënie të thella historike, kulturore dhe njerëzore, të cilat sot gjejnë forcë të re pikërisht në universitet, në dije dhe në formimin e të rinjve.

Të studiosh Mjekësi këtu nuk është një kompromis, nuk është një plan B. Është një mundësi e jashtëzakonshme për t'u hapur ndaj një perspektive ndërkombëtare, për të mësuar ta shihni realitetin me sy tjetër, për të kuptuar se mjekësia është universale, se nuk njuh kufij dhe se i përket mbarë njerëzimit.

Në këtë kampus, në këto auditorë, do të kuptoni se shkenca dhe feja, kompetenca dhe dhembshuria, arsyeja dhe humanizmi mund të ecin së bashk


## THIRRJA E MJEKUT

Themelohet një qendër për ta promovimi

Profesioni i mjekut është ndër manifestimet më të lashta të altruizmit të njerëzimit. Njerëzit gjithmonë i janë përkushtuar në mënyra shumë të ndryshme kujdesit për të tjerët.

Megjithatë sot në shumë vende ka mungesë mjekësh, por vihet re edhe një rënie e motivimit për të zgjedhur këtë profesion. Fondacioni "Nando

dhe Elsa Peretti" ka mirëpritur dhe financuar projektin e arsimit, shëndetësisë dhe solidaritetit ZKM përmes një Qendre për monitorimin dhe promovimin e thirrjes mjekësore. Përfitues janë studentë të mjekësisë dhe mjekë shqiptarë të moshave të ndryshme me qëllim forcimin e identitetit profesional,



qëndrueshmërisë dhe besimit në një vend në tranzicion dhe ende të brishtë.

Në Tokën e Shqiponjave ka 1,2 mjekë për një mijë banorë (mesatarja evropiane është 3,8). Janë të përhapura lodhja dhe humbja e motivimit ndaj ekziston nevoja për të forcuar dimensionin etik, ndjenjën e misionit dhe angazhimin moral.

Projekti synon të përballet me përvojën jetësore të mjekëve/studentëve të krijojë seminare vjetore mbi etikën, empatinë dhe identitetin profesional, të nisë një program mentorimi dhe të integrojë formimin profesional në kurrikulën akademike.

Aktivitetet ndiqen nga një drejtor

akademik (Francesco Rulli) dhe nga një koordinator, nën mbikëqyrjen e një Komiteti shkencor (Fatmir Brahimi, Albert Nikolla, Dukata Radoja, Anila Godo, Claudio Cortese, Jetmir Nikolla). Projekti do të ketë një kohëzgjatje dyvjeçare.

*Në foto: kopertina e akteve në anglisht dhe italisht të një konference mbi thirrjen mjekësore të mbajtur së fundmi në Universitetin ZKM të Tiranës dhe kopertina e biografisë të Mjekut të Nderuar Emanuele Stablum, i Drejtë Ndër Kombe*



## 8 MARS, REFLEKTIM BASHKË ME TË RINJTË

Universiteti feston Ditën Ndërkombëtare të Gruas me aktivitete, sport dhe momente komunitare

**M**ë 9 mars si një reflektim për ditën ndërkombëtare të grave Universiteti Katolik Zoja e Këshillit të Mirë bëri bashkë të rinj, vajza, gra dhe fëmijë që cilët ndanë sëbashku argëtim, lojëra, sporte me dorë, ushqim dhe muzikë për çdo moshë.

Aktivitetet u mbajtën në hapësirat çlodhëse të Kampusit tonë universitar nën kujdesin e Padre Paschal të Pastorales Universitare dhe me mbështetjen e Gender Equality Plan.

Dita ndërkombëtare e grave është një moment jashtëzakonisht përbashkues në të gjithë botën sepse me anë të solidaritetit social vajzat dhe gratë tregojnë fuqinë e butë transformuese në të mirë rë shoqërive.

Ndaj edhe në Kampusin ndërkombëtar UNIZKM kjo ishte një ditë për të ndarë përvojat më të mira mes studentëve, stafit akademik dhe më të vegjëlve që do të rriten me dashurinë për jetën dhe respektin gjinor.

# NJË HAPËSIRË STUDENTORE TEK PARKU I LIQENIT

Jo vetëm arkitekturë!

U rikthyem më 4 mars tek "Syri i Qiellit" në Parkun e Madh të Liqenit Artificial të Tiranës për një tjetër takim që bëri bashkë studentët dhe idetë e tyre për hapësira civile dhe rekreative.

Tema mësimore sprovoi aftësitë e studentëve të Arkitekturës në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", të cilët kërkojnë ide të reja për organizimin e hapësirës hyrëse në Parkun e Madh të kryeqytetit.

Kjo praktikë mësimore në hapësirat urbane u krye nën mentorimin e Prof. Antonio Capestro dhe me kujdesin e Iris Muhametit.

Studentët e vitit të tretë në lëndën Laborator Projektimi realizuan projektet e tyre individuale në arkitekturën civile kushtuar



hapësirave dhe shërbimeve publike. Këto takime që karakterizojnë cilësinë e lartë të kërkesës për novacion në arkitekturë në kohët moderne, i dedikohen të rinjve që mund të

shfrytëzojnë hapësirat rekreative të Parkut të Liqenit Artificial për studim, çlodhje, meditim, lexim apo kohë cilësore me natyrën dhe miqtë.

# NJË DIALOG I HAPUR NË ZEMËR TË TIRANËS

UKZKM tek sheshi  
"Nënë Tereza"

Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Politike dhe Sociale në UKZKM në bashkëpunim me Agjensinë e Parqeve dhe rekreacionit @aprtirana organizuan një takim të hapur me të rinjtë për të diskutuar

mbi ndikimin e ekonomisë në mjedis dhe zhvillimin e tij në harmoni me jetën tonë urbane. Takimi u mbajt në zemër të kryeqytetit tek 'Hënat e Tiranës' ku të rinjtë u bënë pjesë e debatit për mbrojtjen e mjedisit

dhe rrugët që bashkojnë përpjekjet qytetare për rritjen e sensibilizimit në mbrojtje të natyrës duke bërë ekonomi dhe sipërmarrje të gjelbër.



# "WORK & STUDY" TAKIME ORIENTUESE

Prezantimi i Universitetit për maturantët në të gjithë Shqipërinë



**M**egjithëse një qytezë e vogël Librazhdi ka gjallëri rinore. Stenda e Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" paraqiti mes të rinjve programet e studimit duke i ftuar në Open Day në Kampusin tone Universitar në Tiranë.

Edhe në Krujë u çel Panairi Work & Study duke na dhënë mundësinë të takojmë maturantë e rinj që kërkojnë arsim cilësor. Në stendën e ZKM interesi për programet e studimit u duk nga takimet e shumta që koordinatorët

tanë zhvilluan. Në Krujë, qytetin e Heroit tonë Kombëtar si simbol të rezistencës për vlerat perëndimore ne shpalosëm me informacionet që dhamë mundësitë reale që të rinjtë kanë në UKZKM si porta e duhur për arsim me standarde evropiane.

Maturantët e Gramshit u njohën me programet e studimit të Universitetit Katolik duke patur mundësi të orientohen për të bërë zgjedhjen e duhur. Në qytetin e liqeneve dhe zambakëve takuam shumë të rinj që me ëndrrat e tyre pasurojnë një të ardhme më të mirë për Gramshin dhe Shqipërinë.

Panairi na çoi edhe në Vlorë ku UKZKM prezantoi programet e studimit. Duke marrë informacionet e duhura për programet tona të studimit të rinjtë patën mundësi të marrin më shumë hollësi. Ne jemi bërë gati për të ndihmuar ëndrrat tuaja sepse duke zgjedhur UKZKM, keni zgjedhur alternativën e sigurtë për studime të certifikuara evropiane.

Dhjetra maturantë takuam edhe në qytetet e Lushnjës dhe Fierit.

Korca, Pogradeci, Shkodra, Gjirokastra dhe Saranda gjithashtu mikpritën stendat tona. Më shumë informacion do të gjeni në faqen tonë zyrtare.

## PËRVOJAT NDËRKOMBËTARE

UKZKM në Kongresin European të Neurologjisë

**D**r. Erjola Bej anëtare e Departamentit të Vlerësimit Kimik-Toksikologjik dhe Farmakologjik të Barnave në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" mori pjesë me një prezantim të thelluar nën temën "Stresi oksidativ dhe antioksidantët në sëmundjen e Parkinsonit".

Paraqitja e Dr. Bej u krye në Kongresin e katërt Evropian të Neurologjisë dhe Neuropsikiatrisë që u mbajt në Paris në muajin shkurt të këtij viti.

Tema kryesore e konferencës ishte "Sistemi Nervor dhe Shëndeti Mendor dhe Orientimi i së Ardhmes së Neurologjisë dhe Psikiatrisë". Përvoja e fituar nga përfaqësuesja e UKZKM në Paris ishte një mundësi edhe për të ndarë me homologë e partnerë të rejtat në fushën e barnave dhe farmakologjisë.



**M**ë 9-13 dhe 23-28 shkurt 2026 pesë anëtarë të stafit akademik dhe administrativ të Universitetit ZKM morën pjesë në një program mobiliteti për mësimdhënie dhe trajnim pranë Universitetit të Salentos në kuadër të projektit TNE "Health Connect", i financuar nga PNRR - NextGenerationEU me qëllim forcimin e bashkëpunimit akademik dhe shkencor ndërmjet universiteteve italiane dhe atyre të Ballkanit Perëndimor.

# BASHKËPUNIME TË REJA ME UNIVERSITETIN E SALENTOS

Një hap përpara në bashkëpunimin akademik mes universiteteve italiane dhe atyre të Ballkanit Perëndimor

Gjatë mobilitetit u zhvilluan aktivitete të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe takime institucionale me pedagogë dhe punonjës në zyrat e Universitetit të Salentos duke nxitur shkëmbimin e praktikave të mira në fushën e ndërkombëtarizimit, menaxhimit të projekteve kërkimore, mobilitetit akademik dhe politikave gjithëpërfshirëse, si edhe diskutimin e bashkëpunimeve të mundshme akademike për programe studimi të

përbashkëta dhe diploma të dyfishta. **Klodian Muço** dhe **Bardha Karra**, përveç aktiviteteve të mësimdhënies dhe trajnimit pranë Departamentit të Shkencave të Ekonomisë të Universitetit të Salentos kanë nisur gjithashtu diskutime mbi projekte të mundshme kërkimore të përbashkëta mbi tema me interes të veçantë dhe aktuale për rajonin e Ballkanit.

Një rëndësi e veçantë patën edhe aktivitetet kërkimore të zhvilluara nga **Malvina Hoxha**, e ftuar

Paralelisht edhe **Franc Shllaku** pranë Departamentit të Trashëgimisë Kulturore në Universitetin e Salentos mori pjesë në aktivitete akademike dhe kërkimore në fushën e arkitekturës dhe trashëgimisë kulturore me vëmendje të veçantë ndaj temës së mirëqenies në muze dhe vlerësimit të hapësirave ekspozuese duke marrë pjesë gjithashtu në takime akademike, vizita studimore dhe iniciativa shkencore dedikuar praktikave bashkëkohore muzeale. **Dr. Laura Yzeiraj** nga Zyra e Projekteve Formuese e Kërkimore në ZKM kreu vëzhgim të punës dhe komunikoi me zyrat përkatëse të universitetit pritës duke fituar njohuri të thella mbi proceset për hartimin, menaxhimin dhe monitorimin e projekteve ndërkombëtare si dhe strategjitë institucionale për ndërkombëtarizimin dhe bashkëpunimin akademik.


Mobiliteti përfshiu gjithashtu pjesëmarrjen në workshop-in ndërkombëtar "Strengthening Cooperation between the University of Salento and Western Balkans Universities", i organizuar nga Universiteti i Salentos, me koordinimin e **Valentina Ndou** të Departamentit të Inxhinierisë dhe Inovacionit.

Ky aktivitet ishte një mundësi e rëndësishme për shkëmbim idesh ndërmjet universiteteve partnere dhe për prezantimin e aktiviteteve dhe prioritetëve të ndërkombëtarizimit të universitetit.



# THIRRJA PËR JETË ATY KU BESIMI LIND NGA BETEJA

Letra prej zemre



**N**ë këtë numër të buletinit tonë po i dedikojmë këtë ditare grave që përballen me guxim dhe kurajo ndaj sëmundjeve të rënda, por që kurrë nuk e lëshuan Besimin tek Zoti! Heroina të Besimit dhe Shpresës.

Janë ato gra paciente që të sprovuara nga sëmundja, dhimbja, lodhja, zbuluan praninë e Zotit në mes të stuhisë. Janë ato zemra që kaluan

përmes vuajtjes por nuk humbën shpresën sepse janë të thirrura të dhurojnë jetë nga dhimbja e tyre. Janë dëshmi të gjalla se Zoti vepron edhe aty ku njeriu ndien dobësinë e vet.

Me rrëfimet e tyre të sëmundjes, të diagnostikimit, trajtimit me kemioterapi, ato bëhen dritë për ne, thirrje për besim më të thellë dhe ftesë për MIRENJOHJE për vlerën e jetës. Në këtë 8 Mars, përkulemi me respekt

dhe mirënjohje përpara këtyre grave sepse në plagët e tyre shkëlqen forca e besimit e shpresës dhe në betejën e tyre rreh një zemër që i beson jetës si dhuratë nga Zoti.

Më poshtë letrat që pacientet i kanë drejtuar stafit Onkologjik pranë Spitalit Katolik Zoja Këshillit të Mirë.

## ROBIN DHE GITHIN, STUDENTËT E ZOTIT

Përgjithmonë: nuk është një përrallë, por një histori

**P**rej disa muajsh kishin “munguar” në programin e mjekësisë. Një mungesë e justifikuar pasi Robin dhe Githin ishin në Itali për t'u përgatitur për një zgjedhje të rëndësishme për jetën: t'i përkushtoheshin përgjithmonë Zotit. Më datë 1 mars në Saronno së bashku me dhjetë studentë të tjerë nga vende të

ndryshme të botës ata shprehën vendimin e tyre për të nxitur jetën vëllazërore në komunitet duke ndjekur Jezusin në dliresi, varfëri dhe bindje. Një projekt jete që nuk ka të bëjë me ndërtimin e një shtëpie, por me ndjekjen e një rrugëtimi. Tani ata janë kthyer dhe na duken njësoj si më parë, por më shumë se kurrë kanë një të ardhme drejt të cilës mund të ecin së bashku. Të regjistruar në vitin e dytë të mjekësisë në Universitetin Katolik të Tiranës Robin dhe Githin janë shtetas indianë dhe prej disa vitesh anëtarë të Komunitetit të themeluar nga Luigji Monti, infermier dhe edukator i përkushtuar.

Pikërisht Lugji Montit, në qendër të Tiranës, i është kushtuar Poliambulanca që prej tridhjetë vitesh i shërben njerëzve. Emrin e tij e mban edhe Qendra e studimeve të Infermierisë “Montianum”. Zgjedhja bujare e këtyre dy studentëve të rinj universitarë le t'i frymëzojë miqtë e tyre drejt së mirës. Jeta është thirrje, thirrje e Zotit për të mbjellë dashuri në botë. Ky mision mund të realizohet në

shumë forma dhe secili ka rrugëtimin e vet. Robin dhe Githin kanë bërë një zgjedhje të guximshme dhe ne qëndrojmë pranë tyre me dashuri dhe lutje.



Robin dhe Githin, studentë të mjekësisë në Universitetin Katolik të Tiranës, kanë zgjedhur të përkushtojnë jetën e tyre Zotit..

# TË FESTOSH, JETA KA KUPTIM

**24 prill**  
Festa e Fondacionit

**P**o përgatisim gjithçka me përkushtim. Festa vjetore e Fondacionit po afron dhe këtë vit pjesëmarrja do të jetë si gjithmonë, shumë e ndjerë.

Nuk është vetëm ndarja e bursave që tërheq interesin e studentëve, por edhe atmosfera festive e një ngjarjeje shpirtërore. Bëhet fjalë për

Festën patronale të Fondacionit që mban emrin “Zoja e Këshillit të Mirë”, e cila është gjithashtu mbrojtësja e Shqipërisë. Festa zakonisht kremtohet më 26 prill, por në Kampus ajo do të paraprihet të premten, më 24 prill.

Programi do të publikohet së shpejti.

Me rastin e festës do të organizohet një pelegrinazh në Shenjtoren e Shkodrës (në foto) ku të si cdo vit më 25 prill me autobus do të nisemi në orën 7:30 nga parkingu në rrugën Dritan Hoxha pranë UKZKM . Në Shenjtore do të mbahet Mesha e Shenjtë. Rezervimet bëhen në sekretarinë e Presidencës: [k.dema@fzkm.org](mailto:k.dema@fzkm.org).



## SHFAQJA E FILMIT “SINQERISHT GAE”

Bota e Gae Aulentit e treguar në ekranin e madh

**F**ilmi biografik “Sinceramente, Gae” me regji të Didi Gnocchi dhe Matteo Moneta u shfaq më 10 mars pranë Kubit Kinema tek Piramida e Tiranës.

Filmi pasqyron një portret të thelluar të Gae Aulentit, të ndërtuar mbi rrëfimet e bëra në një intervistë të viteve '90 dhe është pasuruar me dëshmi të reja.

Fimi rikthen për publikun jetën e saj

të kaluar me intensitet nga fëmijëria dhe vitet e luftës, te studimet në Politeknik dhe afirmimi profesional në një botë të dominuar nga burrat. Krahas veprave si Musée d'Orsay dhe bashkëpunimit me Luca Ronconi dalin në pah marrëdhëniet personale, pasionet kulturore dhe karakteri i saj jokonformist e magjepsës duke u shfaqur jo pa doza ironie artistike që plotësojnë tregimin për rrugëtimin e saj njerëzor dhe profesional.



Aktiviteti u organizua me kujdesin e Departamentit të Arkitekturës pranë Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" në bashkëpunim me Institutin Italian të Kulturës në Tiranë.

Por kush është Gae Aulenti?

Pak veta e njihnin thellësisht edhe pse ishte e hapur ndaj besimit dhe kujtimeve të saj personale, të treguara përmes një interviste-portret të rrallë.

Intervista e saj dhe rrëfimet e atyre që e njihnin, e donin ose e studionin,

kanë vizatuar për të gjitha kohët një portret të jashtëzakonshëm të një jete të jetuar me intensitet dhe zgjuarsia duke kombinuar arritje të mëdha profesionale me karizmën, kuriozitetin dhe një kulturë të gjerë, fryt i një pasioni të pazakontë për librat dhe udhëtimet.

Gae vjen në film edhe për ata që e njohin vetëm nga vepra e saj me një imazh të pazakonshëm, të dashur dhe simpatik të artistit që zotëron talent.



# GJUHËT SI URA, JO SI MURE

Website i Qendrës Universitare të Gjuhëve "Zoja e Këshillit të Mirë"

[cla.unizkm.al](http://cla.unizkm.al)



Qendra Universitare e Gjuhëve (CLA) e Universitetit Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" paraqet faqen e saj zyrtare të internetit [cla.unizkm.al](http://cla.unizkm.al), një platformë digjitale e kushtuar nxitjes dhe përhapjes së veprimtarive gjuhësore, formuese dhe kulturore të Universitetit. Platforma është krijuar me qëllimin për të ofruar një hapësirë informuese të qartë dhe të aksesueshme, përmes së cilës studentët, pedagogët dhe të interesuarit e tjerë mund të njihen me gamën e gjerë të shërbimeve gjuhësore që ofron Qendra.

Platforma përmbledh informacione të

përditësuar rreth kurseve të gjuhës të organizuara nga CLA, si ato kurrikulare ashtu edhe ekstrakurrikulare, në gjuhët kryesore të studimit të Universitetit, ndër të cilat italishtja, anglishtja, gjermanishtja dhe shqipja. Përmes seksioneve të ndryshme të platformës është e mundur të aksesohen programet e kurseve, aktivitetet e formimit gjuhësor, nismat kulturore dhe projektet e bashkëpunimit akademik të nxitura nga Qendra. Vëmendje e veçantë iu kushtohet gjithashtu certifikimeve ndërkombëtare të gjuhëve, të cilat përbëjnë një nga fushat më të

rëndësishme të veprimtarisë së CLA-së. Platforma ofron informacione të dobishme rreth sesioneve të provimeve, mënyrat e regjistrimit dhe mundësitë e përgatitjes gjuhësore të ofruara për studentët dhe kandidatët e jashtëm. Platforma synon gjithashtu të vlerësojë rolin e Qendrës Universitare të Gjuhëve si një vend takimi ndërmjet gjuhëve, kulturave dhe disiplinave, duke nxitur dialogun ndërkulturor dhe duke mbështetur zhvillimin e kompetencave gjuhësore të nevojshme për formimin akademik dhe profesional në një kontekst gjithnjë e më ndërkombëtar.

# SUKSES EUROPIAN I FIZIOTERAPISTIT TË ZKM

Rruga e suksesit e **Resmi Hoxhës** në një klinikë italiane

**R**emsi Hoxha prej dy vjetësh Rushton me sukses detyrën e fizioterapistit në klinikën e tij në Bolzano të Italisë ku punon edhe bashkëshortja e tij.

Klinika quhet "Fisio Sport Cadamuro" dhe është provë e një përpjekje të gjatë që nga diplomimi deri në ditët që flasim. Rejsi tregon se në Itali u vendos në vitin 2009, ndërsa bashkëshortja e tij në vitin 2002.

Me krenari tregon se arsimimi në UKZKM ishte zgjedhja e duhur sepse,

siç Rejsi thotë, diploma e UKZKM i ka hapur dyert e një bote të re duke e aftësuar në nivele evropiane. Kur kthehet pas në kohë ai kujton stafin e përgatitur akademik që ka luajtur një rol vendimtar në ndërtimin e të ardhmes së tij.

Në Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" njohu shoqen e jetës dhe kjo ngjarje e bukur e bëri më të thjeshtë rrugëtimin e tij. Kur e pyetëm nëse ishte e vështirë të gjente punë kur kishte në duar diplomën ZKM në



një shtet me shëndetësi si Italia, por edhe një vend i anëtar i BE-së, Rejsi tregoi se nuk pati asnjë vështirësi madje ndoqi pa asnjë burokraci shtesë edhe masterin profesional. Të rinjve u thotë të besojnë në aftësitë e tyre dhe të studiojnë çdo ditë sepse me meritokraci arrin kudo.

## NJË ÇMIM QË FORCON PËRKUSHTIMIN PËR NJERËZIMIN

Një letër falënderimi nga **Nihad Suljić** drejtuar anëtarëve të jurisë dhe organizatorëve



*Të nderuar Anëtarë të Jurisë dhe Organizatorë,*

*Po ju shkruaj disa ditë pas kthimit në vendin tim kur përshtypjet e mia më në fund janë qartësuar, por edhe sepse u ktheva menjëherë në punë në terren. Dua të shpreh mirënjohjen time të singertë për çmimin që më keni dhënë. Ky çmim ka një kuptim të veçantë dhe të thellë për mua, e konsideroj jo vetëm një vlerësim personal, por edhe një vlerësim të punës së të gjithë atyre që punojnë në terren çdo ditë, shpesh jashtë vëmendjes. Jam vërtet i nderuar nga ky çmim.*

*U ktheva nga Shqipëria më i fortë, më i vendosur dhe me energji të ripërtërirë për të vazhduar udhëtimin tonë. Mbështetja juaj më jep forcë të mëtejshme dhe tregon se ajo që bëjmë është e vlefshme. Në kohë të*

*vështira vlerësime si këto na kujtojnë pse zgjodhëm këtë rrugë dhe pse nuk mund të ndalemi. Vendimi juaj më inkurajon thellësisht dhe më motivon të vazhdoj - me solidaritet, përgjegjësi dhe përkushtim ndaj atyre që kanë më shumë nevojë.*

*Jam i gatshëm të bëj çfarëdo që mundem dhe mbetem gjithmonë i hapur për bashkëpunim dhe nisma të përbashkëta. Ky çmim nuk më përket vetëm mua, por të gjithë atyre që besojnë në dinjitetin e çdo qenieje njerëzore dhe që nuk ndalen kurrë së luftuari për njerëzimin, pavarësisht vështirësive.*

*Faleminderit që e njihni dhe mbështetët këtë udhëtim. Dyert e Bosnjës dhe Hercegovinës janë gjithmonë të hapura për ju; jeni të mirëpritur si miq dhe partnerë.*

# DIELL SOT, PAQE NESËR

**L**ufta na rikujton gjithmonë se sa e brishtë është ajo që e mendonjmë të qëndrueshme.

Mjafton një konflikt dhe menjëherë energjia shtrenjtësohet, pakësohet dhe është e pasigurt. Çmimet rriten, familjet shqetësohen, qeveritë kërkojnë furnizues të rinj, rihapen centrale që dukeshin të destinuar për t'u mbyllur, nënshkruhen marrëveshje me nxitim, shpesh me vende që deri një ditë më parë konsideroheshin të largëta ose të vështira. Flitet për emergjencë, sikur të ishte diçka e papritur.

E megjithatë, nuk është hera e parë që ndodh. Çdo krizë energjetike duket se na befason, por në fakt çdo krizë lind nga një varësi që e kemi ditur prej kohësh. Prej vitesh e dimë se ndërtimi i sistemit energjetik mbi burime të kufizuara, të përqendruara në disa zona të botës dhe të lidhura me ekuilibra ndërkombëtarë të paqëndrueshëm, do të thotë të ekspozohesh ndaj tensioneve të përsëritura. Gazi, nafta dhe qymyri kanë bërë të mundur një rritje të jashtëzakonshme, por kanë krijuar edhe një sistem që funksionon mirë për sa kohë gjithçka mbetet në

Balancë  
e pasigurt,  
vendime  
të vonuara

nga **Valentina Rotondi**

Ligjëruese, kërkuese në SUPSI  
dhe shkencëtare sociale



ekuilibër por bëhet vulnerabël sapo ky ekuilibër prishet. Është e habitshme që ky vulnerabilitet nuk është një zbulim i kohëve të fundit. Prej kohësh e dimë se ekzistojnë alternativa të bazuara në burime të rinovueshme si dielli, era, uji, energjia gjeotermike, të cilat për nga vetë natyra e tyre ulin varësinë nga pak vende, nga pak rrugë furnizimi dhe nga pak momente. Janë burime të përhapura gjerësisht, të disponueshme në shumë kontekste, më pak të ekspozuara ndaj ndërprerjeve të papritura që shoqërojnë krizat gjeopolitike. Megjithatë, për dekada të tëra ato janë trajtuar si një mundësi shtesë, si diçka për t'u zhvilluar ngadalë, në përputhje me atë që tashmë ekziston.

Nuk është naive të mendosh se tranzicioni është kompleks. E di mirë që problemi i akumulimit nuk është dytësor, se çështja e baterive, rrjeteve dhe menaxhimit të prodhimit të ndërprerë është reale dhe kërkon investime të mëdha, kërkime dhe kohë. Askush nuk mendon se mjafton të instalohen panele apo turbina për të zgjidhur gjithçka. Por pikërisht për këtë arsye, është e habitshme që është shtyrë për kaq gjatë, sikur stabiliteti i

sistemit aktual të ishte i garantuar, sikur krizat të ishin përjashtime dhe jo një mundësi e përsëritur.

Burimet e rinovueshme nuk janë perfekte. Megjithatë, të vazhdojnë të bazosh ekonominë pothuajse tërësisht në burime të shtershme dhe të përqendruara e bën të pashmangshme që, herët a vonë, të gjendesh në situatën që po përjetojmë. Çdo herë reagojmë duke kërkuar furnizime të reja, marrëveshje të reja, zgjidhje të përkohshme, ndërsa struktura bazë mbetet e njëjtë.

Kjo vështirësi për të ndryshuar nuk varet vetëm nga teknologjia, por edhe nga mënyra se si jemi mësuar të vlerësojmë se çfarë është më e mira.

Kemi priirjen të preferojmë zgjidhje që funksionojnë menjëherë, që integrohen lehtësisht në sistemet ekzistuese dhe që nuk kërkojnë transformime të thella. Na duket më realiste të përshtatim atë që kemi sesa të ndërtojmë diçka ndryshe, edhe kur e dimë se sistemi aktual është i brishtë. Krizat energjetike tregojnë qartë se sa shumë varet mirëqenia jonë nga ekuilibra të brishtë dhe sa pak kemi investuar që mund ta bënim atë më rezistente në planin afatgjatë.

Burimet e rinovueshme nuk i eliminojnë të gjitha problemet, por ndryshojnë natyrën e varësisë, ulin ekspozimin ndaj goditjeve dhe bëjnë të mundur një organizim më të përhapur dhe më pak vulnerabël.

Sa herë që një luftë apo një tension ndërkombëtar e trondit sistemin energjetik, rikthehemi të flasim për tranzicionin sikur të ishte një projekt për të ardhmen.

Megjithatë, gjithnjë e më shpesh ai shfaqet si diçka që duhej ta kishim marrë seriozisht shumë më herët, jo nga idealizmi, por thjesht nga matura.



Një nga  
impiantet  
diellore në  
Universitetin  
Katolik të  
Tiranës



Alda Merini

### HIMN PËR GRUAN

Ka gra...

Pastaj ka gra, gra...

Ato nuk duhet me provu m'i kuptue,  
kish' me kanë një betejë e humbun n'fillesë.

Duhesh m'i pranue, qaq.

Duhet m'i marr e puthë,

mos me iu dhanë kohë, kohën me u mendue.

Me i pushtue duhesh n'përqafim

që dahun ua ndal e frikën

që din me t'rrëxue një herë të vetme,

veç një herë, pa zà, zà t'fikun.

Sepse marrohen prej dobësive t'veta e,

pasi i kanë pëshpëritë para nesh vuajnë - në një agoni

të ngadal't e t'pa fjalë - me mendimin se,

tuj zbulue fytyrën, tuj kallxue femsinë

e tuj u shfaqë në nevojë për një çast të mos marres,

kanë me pa shpatullat tua të kthyme

e hapat tu n`largim.

Prandaj, afroni dhe duajini, ato. Duajini të veshuna,  
se zdeshun tana janë të mira.

Duajini t'pa mbrojtuna e t'pa makiazh qysh janë,

se nuk e din kurr kur sytë e një gruaje

kanë me gjetë mburojen mas velos së një pudre.

Duajini kur janë të përgjumuna, t'plagosuna

e gjumi i këputë.

Duajini tuj e ditë se nevojë nuk kanë:

vetvetës dinë m'i mjaftue.

E bash për këtë, dijnë me të dasht

ty qysh asnja tjetër ka ditë ma parë.



Mimoza Agastra

### BRENDA NJË GRUAJE...

Brenda një gruaje rri një dhimbje e thellë,  
që flet me sy, me heshtje, me mall të pashkelë,  
me një dritë të zbehtë në shikimin e humbur,  
dhe zemrën që rreh si një gjëmim i strukur.

Brenda një gruaje fle një ëndërr e ngrirë,  
që druhet të nisë drejt pasionit të lirë,  
natën ajo thur ndjenja në heshtje të plotë,  
e në agim struket në vetminë e ftohtë.

Brenda një gruaje lind një botë e tërë,  
me ngjyra jete që treten ngadalë në erë,  
ajo është dashuri, dritë që s'di urrejtje,  
që fal gjithçka edhe kur thyhet në heshtje.

Në shpirtin e saj digjen stinë të pafjalë,  
dhimbja bëhet forcë, loti bëhet valë,  
se gruaja di të ringrihet përsëri,  
edhe kur jeta e copëton në mijëra thërmi.

### NËNË

Nënë, si bëhem si ti një ditë,  
me atë dritë që mban në sy?  
Si ta kem fjalën plot ngrohtësi,  
që terrin ma kthen në dritë?

Si ta mbaj atë zjarr në shpirt,  
që ti ma rrite dalëngadalë?  
Të jem për bijtë e mi një strehë,  
siç ishe ti për mua çdo çast?

Nëse një grimë nga shpirti yt  
më rreh në zemër e në gjak,  
ndoshta një ditë do ta kuptoj:  
dashuria jote s'ka kufi.

# TAKIMET E ARDHSHME



UNIVERSITETI KATOLIK  
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

18 PRILL / APRILE 2026

# OPEN DAY



UNIVERSITÀ CATTOLICA  
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO



8<sup>a</sup> CONFERENZA  
INTERNAZIONALE  
MONTIANUM

**NURSING OGGI: INTELLIGENZA ARTIFICIALE,  
FARMACOTERAPIA AVANZATA  
E MODELLI PREDITTIVI NELLA CURA 4.0**

*"Una professione tra radici storiche,  
sinergia interprofessionale  
e gestione etica del rischio clinico  
in un contesto internazionale"*

1<sup>o</sup>  
giugno  
2026

Aula Magna  
Università Cattolica  
"Nostra Signora del Buon Consiglio"  
Tirana, Albania



UNIVERSITÀ CATTOLICA  
NOSTRA SIGNORA DEL BUON CONSIGLIO  
PASTORALE

BE PART.



# ZKM TORNEO 2026

Calcio	10 Aprile-23 Aprile
Pallavolo	27 Aprile-9 Maggio
Scacchi	24 Aprile-25 Aprile
Burraco	7 Maggio-8 Maggio
Ping Pong	2 Maggio
Grande Premio	9 Maggio



FONDAZIONI  
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

*Përkushtuar edukimit, përkushtuar shëndetit*

# FESTA E FONDACIONIT ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

24 PRILL 2026

Kampus ZKM, Tiranë



# *Gëzuar Pashkët!*

Pashkët e ngjalljes së Jezusit qofshin për të gjithë ne shpresë e sigurt që jeta nuk është e përfunduar, ashtu si horizonti nuk është një kufi, por një prag.



**FONDACIONI  
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË**  
Përkushtuar edukimit, përkushtuar shëndetit

**ZKM  
ALBANIA**